



**Organizata Jo-qeveritare Emancipimi Civil Ma Ndryshe
EC MA NDRYSHE**

29 gusht 2017, Prizren

KOMUNIKATË PËR MEDIA

Komuna e Prizrenit me mjete publike ndërton trotuar që pengon lirinë e lëvizjes

EC Ma Ndryshe ka realizuar performancën publike në sheshin para ndërtesë së Postës në Prizren përkatësisht “Monumentit të Lirisë”, me anë të cilës është shprehur pakënaqësia për vendosjen e pengesës në mes të trotuarit. Në këtë hapësirë publike të qendrës historike të qytetit, intervenimi i Komunës së Prizrenit me mjetet financiare publike në vend se të krijojë një trotuar të qashtëm për të gjithë përkundrazi ka krijuar një mjedis që pengon lirinë e lëvizjes për të gjitha kategoritë e shoqërisë.

Në kuadër të performancës, me një kuti me pasqyre është mbuluar njëra pjesë e pengesës, që ndodhet në mes të trotuarit. Në këtë mënyrë pasqyrohet rruga në të dy anët për të arritur efektin optik se gjoja kalimi është i hapur.

Performanca publike është realizuar pas kërkesave të banorëve të qytetit dhe EC-it të adresuara në Komunën e Prizrenit për largimin e pengesës në fjalë, por autoritetet lokale deri më tani nuk kanë marrë masa në këtë drejtim, duke pamundësuar lëvizjen e lirë të qytetarëve.

Në hulumtimet e mëparshme, EC ka argumentuar se përse planifikimi dhe ndërtimi duhet ti përmbushin nevojat e të gjitha kategorive të shoqërisë, dhe përse hapësira e ndërtuar nuk duhet të ketë pengesa, ashtu që ti përmbush nevojat e të gjithë njerëzve në mënyrë të barabartë.

Sipas këtyre hulumtimeve del se planifikimi i intervenimeve ndërtuese dhe identifikimi i problemeve dhe nevojave nuk bëhet duke përfshirë komunitetin në këtë proces. Andaj mjedisi i ndërtuar vazhdon të jetë i paqashtëm, si dhe komunitetet e prekura nga këto aktivitete planifikuese dhe ndërtimore, e në veçanti PAK, vazhdojnë të përballen me barriera në qytet. Ato pak përprjekje që bëhen për të lehtësuar qasjen, bëhen sa për sy e faqe, pa i marrë parasysh të gjitha rregullat që janë pjesë e UA 33/2007 apo nevojat e komunitetit që do ta shfrytëzojë atë mjedis. Gjithandej në qytet mund të shihen intervenime gjysmake që kanë për qëllim përmbushjen sipërfaqësore të kriterit ligjor, por jo edhe zgjidhjen e problemeve reale. Inspektorët komunalë i kapërcejnë këto kriteret gjatë vëzhgimit të implementimit të këtij udhëzimi administrativ, duke u thirrur edhe në mungesë të kapaciteteve njerëzore. Kjo ndodh në të dy rastet, edhe kur kemi të bëjmë me punët përmirësuese dhe për punët e ndërtimeve të reja, të cilat normalisht do të duhej të ishin në pajtim të plotë me kriteret e këtij udhëzimi administrativ.

Bllokimi i trotuareve në qytetin e Prizrenit gjatë viteve të fundit është veçuar si njëri prej shqetësimeve kryesore të banorëve të Prizrenit në kuadër të anketimit të tyre nga EC-i mbi planifikimin urban.

“Qytetet Gjithëpërfshirëse...” është projekt i EC, i cili synon të artikulojë nevojat e grupeve të komunitetit dhe t'i përkthejë ato në plane të zbatueshme urbane të komunës së Prizrenit. Grupet e komunitetit me të cilat punohet në këtë projekt janë të shpërndarë në lagje dhe fshatra të ndryshme të komunës së Prizrenit.

Me respekt,
Hajrulla Ceku, EC Ma Ndryshe

Projekti "Qytetet Gjithëpërfshirëse" - promovimi dhe përhapja e metodologjisë së planifikimit urban me pjesëmarrje" përkrahët financiarisht nga Olof Palme International Center, që përkrahët nga Qeveria e Suedisë

